

PARTIA SOCIALDEMOKRATE (PSD)

HISTORIKU

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë (PSD) u krijua në mars të vitit 1991, dhe u bë anëtare e Internacionales Socialiste në vitin 1992. Që në fillimet e saj, kryetar i PSD ishte Skënder Gjinushi, që kishte shërbyer si Ministër i Arsimit përgjatë viteve 1987 – 1991. Megjithëse PSD kontestoi zgjedhjet e vitit 1992, ajo arriti që të fitonte shtatë vende në parlamentin e legjislaturës midis viteve 1992- 1996. PSD vendosi që të mos marrë pjesë në zgjedhjet e 26 majit 1996 dhe kontestoi organizimin e tyre sëbashku me Partinë Socialiste dhe parti të tjera opozitare. Në zgjedhjet e parakohëshme të qershorit 1997, PSD arriti që të fitonte 9 vende në parlament. Në gusht të vitit 1999, pati debate të ndryshme brenda PSD, të cilat sollën krijimin e një fraksioni të udhëhequr nga Gaqo Apostoli, i cili më pas krijoi një parti tjetër më vete. Në zgjedhjet elektorale të vitit 2001, Partia Socialdemokrate u reduktua në katër mandate deputetësh. Zgjedhjet e vitit 2005 sollën sërish një rritje të elektoratit të saj, të favorizuar dhe nga sistemi elektor i ri dhe koalicioni me Partinë Socialiste, gjë që solli që ajo të fitonte sërish shtatë vende në parlament. Në vitin 2009, PSD ishte pjesë e Aleancës për Ndryshim, por mori vetëm 1.8% të votave në nivel kombëtar dhe nuk mundi që të përfaqësohej në parlament. Po ashtu dhe gjatë zgjedhjeve të vitit 2013, PSD nuk mundi që të përfaqësohej në Kuvend. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2017, Partia Socialdemokrate arriti që të fitonte vetëm një mandat deputeti. Partia Socialdemokrate u c'anëtarësua nga Internacionalja Socialiste gjatë vitit 2014. Ndërkohë, kryetari historik i saj Skënder Gjinushi u zgjodh kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe dha dorëheqjen nga PSD në qershor të vitit 2019. Ai u zëvendësua nga Ëngjell Bejtaj.

KRYETARI - ËNGJËLL BEJTAJ

JETËSHKRIMI

Ëngjell Bejtaj u zgjodh kryetar i Partisë Socialdemokrate në qershor të vitit 2019, pas dorëheqjes së kryetarit historik të saj Skënder Gjinushit, i cili u zgjidh Kryetar i Akademisë së Shkencave. Ëngjell Bejtaj është mjek në profesion dhe ka mbajtur postin e shefit të Shërbimit të Kirurgjisë pranë Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi". Më herët ai ka qenë deputet në radhët e Partisë Social Demokrate.

ZYRTARËT PËRFAQËSUES

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Malësi e Madhe

9 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Shkodër

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Tropojë

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Has

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Fushë Arrëz

12 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Vau i Dejës

3 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Pukë

6 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Lezhë

3 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Mirditë

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Mat

3 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Dibër

2 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Kurbin

2 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Klos

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Tiranë

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Kamëz

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Elbasan

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Belsh

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Lushnjë

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Divjakë

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Korçë

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Devoll

3 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Pustec

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Maliq

2 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Pogradec

2 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Gramsh

2 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Berat

3 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Selenicë

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Vlorë

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Fier

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Patos

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Mallakastër

4 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Gjirokastrë

1 mandat për në këshillin bashkiak – Bashkia Sarandë

2 mandate për në këshillin bashkiak – Bashkia Himarë